



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo



Komuna e Gjiçanit
Opština Gjiçane
Municipal Gjiçane
Gilan Belediyesi

DREJTORIA E ARSIMIT

Në bazë të Ligjit për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës neni 5 pika c, Ligji për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës neni 35, Ligji i Punës së Republikës së Kosovës neni 8, Drejtoria e Arsimit në Gjiçan shpallë këtë :

K O N K U R S PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË LIRA TË PUNËS

Institucioni Parashkollor “Dardania” në Gjiçan

- Dhjetë (10) Edukatore

Kushtet e konkursit :

Kualifikimi për mësimdhënës : kërkohet përgatitja adekuate profesionale : Fakulteti i Edukimit – Programi Parashkollor . Të gjithë kandidatët të cilët kanë mbaruar studimet jashtë Shtetit të Republikës së Kosovës e që konkurrojnë për këto vende të punës, duhen që diplomat e tyre (gradat universitare të fituara) të jenë të njohura nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në pajtim me udhëzimin administrativ të MASHT-it,, nr. 8/2010,në të kundërtën komisioni gjatë selektimit të aplikacioneve, do të refuzoj çdo aplikacion të kandidatëve të cilët nuk e kanë plotësuar këtë kusht të konkursit.

Për vendet e punës në fjalë nevojiten këto dokumente: diploma mbi përgatitjen profesionale, kopja e letërnjoftimit, vërtetim mbi përvojën e punës, certifikatën e lëshuar nga sektori gjendjes civile me të cilin dëshmohet vendbanimi i kandidatit, vërtetimi nga gjykata kompetente se personi nuk është nën hetime. Të gjitha duhen të jenë kopje dhe nuk kthehen.

Për këto vende të punës, kandidatët do t’i nënshtrohen intervistës me gojë.

Komisioni do të bëjë selektim të aplikacioneve dhe në intervistë ftohen vetëm ata kandidatë të cilët i plotësojnë kushtet e konkursit dhe në pajtim me normativet e MASHT-it në fuqi.

Dokumentet e pakompletuara dhe ato të dorëzuara pas afatit nuk do të merren në shqyrtim.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga shpallja në gazeta zyrtare dhe në mjetet e tjera të informimit

Të gjithë kandidatët e interesuar duhet t’i marrin aplikacionet dhe të plotësuara të dorëzohen pranë Qendrën për Shërbim të Qytetarëve në Gjiçan.